



INFORMACION PËR ZGJEDHJET RAJONALE 2022

Reforma sociale shëndetësore (sote-reforma) hyn në fuqi me 1.1.2023. Në reformë, përgjegjësia për mirëqenien sociale shëndetësore si dhe veprimet e shpëtimit transferohet nga komunat në 21 rajone të mirëqenies. Qyteti Helsinki sidoqoftë nuk është rajon i mirëqenies e as nuk bën pjesë në asnjë rajon të mirëqenies dhe vet kujdeset për shërbimet sociale shëndetësore dhe për veprimet e veta të shpëtimit.

Rajonet e mirëqenies janë komunitete juridike publike të ndara nga komunat dhe nga shteti që kanë autonomi/vetëqeverisje në rajon. Rajonet krijohen kryesisht në bazë të ndarjes së krahinave. Në krahinën Uusimaa sidoqoftë ka katër rajone të mirëqenies.

Organi më i lartë vendimprues i rajonit të mirëqenies është Këshilli i rajonit i zgjedhur nga ana e banorëve të atij rajoni. Anëtarët e Këshillit të rajonit apo delegatët zgjidhen në zgjedhjet rajonale.

Zgjedhjet e para rajonale do të mbahen **të dielen 23.1.2022**. Mandati i Këshillit rajonal të zgjedhur në këto zgjedhje fillon në fillim të marsit 2022 dhe vazhdon deri në fund të majit 2025. Nga viti 2025 zgjedhjet rajonale do të mbahen në të njejtën kohë me zgjedhjet komunale.

Në zgjedhjet rajonale mund të votojnë dhe të kandidohen qytetarët e moshës madhore të Finlandës që banojnë në Finlandë dhe me kushte të dhëna edhe qytetarët e shteteve tjera që banojnë në Finlandë.

Votimi në Finlandë është vullnetar.

Në qytetin Helsinki dhe në rajonin e krahinës Ahvenanmaa nuk mbahen zgjedhjet rajonale.

E drejta e votës – kush mund të voton

Mund të votoni në zgjedhjet rajonale nëse jeni qytetar i Finlandës ose i ndonjë shtetit tjetër të Unionit europian apo i Islandës ose Norvegjisë dhe nëse i plotësoni këto kushte:

- i mbushni deri në ditën e votimit (23.1.2022) 18 vite
- jeni banor rezident i Finlandës me datën 3.12.2021 në komunën që i takon ndonjë rajonit të mirëqenies

Nëse jeni qytetar i ndonjë shteti tjetër, mund të votoni në zgjedhjet rajonale nëse:

- i mbushni deri në ditën e votimit (23.1.2022) 18 vite

- jeni banor rezident i Finlandës me datën 3.12.2021 në komunën që i takon ndonjë rajonit të mirëqenies
- jeni banor rezident pa ndërprerje në ndonjë komunë të Finlandës për të paktën dy vite para 3.12.2021

Komuna e rezidencës përcaktohet sipas ligjit për komunën e rezidencës. Në parim, komuna e rezidencës është komuna ku banoni.

Komuna e rezidencës përcakton edhe atë se cilit rajon të mirëqenies i takoni, pra atë se në zgjedhjet rajonale të cilit rajon të mirëqenies keni drejtë vote. Në zgjedhjet rajonale mund të votoni vetëm për kandidatin e rajonit të juaj të mirëqenies.

Në zgjedhjet rajonale 2022 komuna e rezidencës së juaj përcaktohet sipas asaj se cila komunë është regjistruar si komunë e rezidencës së juaj në sistemin e informacioneve të popullatës deri me datën 3.12.2021 në ora 24.

Sipas nevojës mund ta verifikoni komunën e rezidencës te Agjencia dixhitale e informacioneve për popullatën.

Lajmërimi për të drejtën e votës i dërgohet të gjithëve që kanë drejtë vote

Agjencia dixhitale e informacioneve për popullatën mbanë regjistrin e atyre që kanë drejtë vote në të cilin gjinden të dhënat e secilit që ka të drejtën e votës. Nuk ka nevojë të lajmëroheni veçmas në regjistrin e atyre që kanë drejtë vote.

Agjencia dixhitale e informacioneve për popullatën ju dërgon para **30.12.2021** lajmërimin për të drejtën e votës apo kartën lajmëruese secilit që keni drejtë vote dhe adresë të lajmëruar. Kartën lajmëruese do ta merrni në mënyrë elektronike nëse keni filluar të përdorni shërbimin e mesazheve elektronike të ofruar nga Agjencia dixhitale e informacioneve për popullatën apo Suomi.fi-viestit (informacione tjera në adresën www.suomi.fi/viestit).

Në lajmërimin për të drejtën e votës janë udhëzimet se si të votoni, informacionet për vendin e juaj të votimit në ditën e zgjedhjeve, informacionet për detyrat e Këshillit rajonal si dhe lista e vendeve të votimit paraprak afër vendbanimit të juaj. Në vendin e votimit nuk keni nevojë për fletën e lajmërimit për të drejtën e votës, mjafton dokumenti i identifikimit.

Përshtatshmëria zgjedhore – kush mund të bëhet kandidat

Keni përshtatshmëri zgjedhore apo mund të kandidoheni si kandidat në zgjedhjet rajonale të rajonit të juaj nëse i plotësoni këto kushte:

- komuna juaj i takon rajonit të mirëqenies për Këshillin rajonal të të cilit mendoni të kandidoheni
- keni të drejtën e votës diku në rajonin e mirëqenies
- nuk jeni shpallur si i paaftë me vendim të gjykatës.

Disa zyrtarë të shtetit dhe zyrtarët dhe punonjës udhëheqës të rajonit të mirëqenies të listuar në ligjin e rajonit të mirëqenies nuk kanë përshtatshmëri zgjedhore në zgjedhjet rajonale.

Emërimi i kandidatëve për zgjedhjet rajonale

Kandidatët për zgjedhjet rajonale mund ti emërojnë

- partitë e regjistruara
- personat me drejtëvotë që kanë themeluar shoqatën zgjedhore.

Partitë vendosin për kandidatët e tyre në përputhje me rregullat e veta. Nëse dëshironi të bëheni kandidat i partisë, për këtë gjë duhet të mirreni vesh me partinë.

Për të themeluar shoqatën zgjedhore nevojiten së paku 50 banorë të rajonit të mirëqenies që kanë drejtë vote.

Dy ose më tepër parti kanë të drejtë të themelojnë aleancë zgjedhore. Dy ose më tepër shoqata kanë të drejtë të themelojnë listën e përbashkët.

Partia, shoqata zgjedhore apo lista e përbashkët në rajonin e mirëqenies mund të kenë kandidatë maksimalisht 1,25 herë më tepër se numri i delegatëve që zgjidhen. Në Këshillin e rajonit, në bazë të numrit të banorëve të rajonit të mirëqenies, zgjidhen 59–79 delegatë.

Secili kandidat ka numrin e vet. Nga kandidatët bëhet një kombinim i printuar i listave të kandidatëve në të cilin kandidatët me rradhë shënohen me numra duke filluar nga numri 2. Në kombinimin kandidatët janë ndarë në grupe sipas partive dhe sipas listës së përbashkët. Për secilin kandidat nga kombinimi i listës gjinden këto shënime: emri, numri i kandidatit dhe titulli/profisioni/puna si dhe komuna e rezidencës. Në kombinimin e listës së kandidatëve poashtu shifet se

- cilat parti kanë formuar aleancën zgjedhore
- cilat shoqata zgjedhore kanë formuar listën e përbashkët
- cilat parti nuk bëjnë pjesë në aleancën zgjedhore
- cilët kandidatë janë kandidatë që gjinden jashtë listës së përbashkët.

Kombinimet e listave të kandidatëve bëhen në të gjitha rajonet e mirëqenies deri me 23.12.2021. Kombinimi i listave të rajonit të juaj të mirëqenies mund të shifet në mes tjerash në kabinën e votimit dhe në faqet zgjedhore të Ministrisë së Drejtësisë (www.vaalit.fi). Nëse votoni paraprakisht diku tjetër jashtë rajonit të juaj të mirëqenies, nga nëpunësi i zgjedhjeve mund të kërkonte librin e kandidatëve ku janë të listuara të dhënat e kandidatëve të gjithë rajoneve të mirëqenies.

Koha e votimit

Mund të votoni në ditën e zgjedhjeve të dielen me 23.1.2022 ose para ditës së zgjedhjeve gjatë periudhës së votimit paraprak. Mund të votoni vetëm një herë. Për votim dy herë është përcaktuar denimi sipas Kodit penal.

Votimi paraprak:

Votimi paraprak fillon **të mërkuren 12.1.2022**.

Votimi paraprak jashtë shtetit përfundon **të shtunen 15.1.2022** dhe në Finlandë **të martën 18.1.2021**. Në disa vende të votimit paraprak koha e votimit është më e shkurtë.

Mund të votoni paraprakisht në cilin do vend të votimit paraprak në vend apo jashtë vendit. Vende të votimit paraprak janë

- komunitat i përcaktojnë vendet e votimit paraprak në vend, shpesh për shembull janë zyret e komunës
- shumë përfaqësi të Finlandës jashtë vendit
- institucionet/entet, si spitalet, zyret sociale dhe burgjet apo entet ndëshkuese. Në institucione mund të votojnë vetëm ata që trajtohen aty ose që janë marrë aty.
- anijet finlandeze të cilat gjinden jashtë vendit gjatë kohës së votimit paraprak. Në anije mund të voton vetëm stafi i anijes, pasagjerët nuk mund të votojnë në anije.

Votimi në ditën e zgjedhjeve:

Votimi në ditën e zgjedhjeve bëhet **të dielen 23.1.2022 nga ora 9–20**.

Në ditën e zgjedhjeve mund të votoni vetëm në atë vendvotim që është shënuar në lajmërimin e drejtës së votimit që ju është dërguar.

Votimi në shtëpi:

Nëse aftësia e juaj për të lëvizur apo funksionuar është e kufizuar aq shumë dhe nuk mund të dilni te vendvotimi pa vështërsi të tepërta, atëherë mund të votoni në shtëpi gjatë periudhës së votimit paraprak.

Për votim në shtëpi duhet të lajmëroheni deri **të martën 11.1.2022** para orës 16. Lajmërimi duhet bërë bordit zgjedhor qendror, të dhënat e të cilit i gjeni në lajmërimin e të drejtës së juaj të votimit. Kujdestarja/-ri që banon në të njejtën shtëpi mund të voton njëkohësisht por me disa kushte të caktuara.

Votimi me letër:

Nëse gjatë tërë periudhës së votimit paraprak dhe ditën e zgjedhjeve gjendeni jashtë vendit, mund të votoni edhe me letër nga jashtë.

Për votim me letër duhet të porositni materialin për votim me letër nga shërbimi i Ministrisë së Drejtësisë për porositje në ndonjë adresë jashtë vendit. Porositjen mund ta bëni jo më heret se tre muaj para ditës së zgjedhjeve. Si person që keni drejtë vote keni përgjegjësi që vet me kohë të porositni dokumentet për votim me letër që të mund ta këtheni zarfin me votën e juaj bordit zgjedhor qendror të komunës së juaj në afat të caktuar me ligj.

Kështu votoni

Votimi paraprak dhe votimi në ditën e zgjedhjeve bëhet te vendvotimi. Mund të votoni vetëm për një kandidat që është në kombinimin e listave të kandidatëve të rajonit të juaj të mirëqenies.

1) Vërtetoni identitetin e juaj te nëpunësi i zgjedhjeve duke i treguar pasaportën, ID-kartën, patentën e shoferit apo tjetër dokument të tillë. Nëpunësi i zgjedhjeve ju jep fletëvotimin.

2) Shkoni në kabinën e vvotimit. Në kabinën e votimit mund të jetë vetëm një person.

3) Shënoni në fletëvotim numrin e kandidatit që e votoni. Mund të votoni vetëm për një kandidat. Shënoni numrin e kandidatit në rrethin brenda fletëvotimit. Mos bëni shënime tjera në fletëvotim. Paloseni fletëvotimin ashtu që numri që keni shënuar të mbetet në pjesën e brëndshme dhe mos të shifet nga jashtë.

4) Dërgoni fletëvotimin e palosur te nëpunësi i zgjedhjeve. Nëpunësi i zgjedhjeve vulos fletëvotimin.

5a) Nëse votoni në ditën e zgjedhjeve, hidhni fletëvotimin e vulosur në kutinë e votimit.

5b) Nëse votoni në votime paraprake, nëpunësi i zgjedhjeve ju jep zarfin ku do ta mbyllni fletëvotimin e vulosur.

Nëse nuk keni aftësi të mjaftuar për ta shënuar numrin e kandidatit në fletëvotim, mund të përdorni për asistim në votim ndihmësin që keni zgjedhur vet ose nëpunësin e zgjedhjeve. Ndihmësi nuk guxon të jetë personi që kandidohet në zgjedhje e as familjar i afërm i kandidatit. Ndihmësi ka obligim të ruaj sekretin e zgjedhjeve, pra të mbanë sekrete informacionet e kuptuara gjatë votimit.

Informacione tjera

- Informacione tjera për zgjedhjet jep bordi zgjedhor qendror i komunës. Në pyetjet personale për të drejtën e votimit përgjigjet Agjencia dixhitale e informacioneve për popullatën. Shënimet e kontaktit për të dy gjinden në lajmërimin për të drejtën e votës.
- Adresat dhe kohërat e hapjes së vendeve të votimit paraprak, udhëzimet për porositjen e votimit me letër, informacionet për kandidatët si dhe informacione tjera për zgjedhjet gjinden në faqet zgjedhore të Ministrisë së Drejtësisë www.vaalit.fi.
- Informacionet për kandidatët në zgjedhjet rajonale i gjeni në faqet zgjedhore të Ministrisë së Drejtësisë pas datës 23.12.2021 dhe informacionet për vendet e votimit paraprak pas datës 5.11.2021.